

S T A T U T I
I SHOQERISE ME PERGJEGJESI TE KUFIZUAR ME EMERTIMIN "FERRA & CO" (SHPK)
D U R R E S

Shoqeria me pergjegjesi te kufizuar me emertimin "Ferra & Co"(shpk) Durres,veprimtarine e saj blerese,perpunuese dhe tregetuese,do ta zhvilloje ne baze te ligjeve te shtetit shqiptar dhe ne baze te ketij statusi.Ajo do ti perbahet objektit te veprimtarise per te cilen eshte krijuar dhe miratuar.

Aktivitetin e saj shoqeria "Ferra & Co"(shpk) Durres,do ta zhvilloje me pjesmarrjen e ortakut te vetem administrator :

1. Ramazan Ferra,i biri i Isufit,i datelindjes 1935,me banim ne Lagjen Nr.3 Rruga "Hamdi Troplini" Nr.642 Durres.Me cilesine e ortakut te vetem administrator te shoqerise "Ferra & Co"(shpk) Durres.

KREU I -re
FORMA,EMERTIMI,OBJEKTI,KOHEZGJATJA

Neni 1

Ne zbatim te Ligjit Nr.7512,date 10.08.1991,mbeshtetur ne kreun e IV-te te Ligjit Nr.7638,date 19.11.1992 "Per shoqerite tregetare",dhe Nenin 64 te Ligjit Nr.7667,date 28.01.1993 "Per regjistrin tregetar",shoqeria "Ferra & Co"(shpk) Durres,disponon Kontraten e Themelimit te noterizuar.Ajo.do te zhvilloje aktivitetin e saj sipas objektit qe ka,dhe ne baze te ligjeve te shtetit shqiptar,dhe te vete statutit te miratuar nga ortaku i vetem administrator.Shoqeria do te veproje me rregjimin e pergjegjesise se kufizuar.

Neni 2

Shoqeria qe do te krijohet do te kete emertimin "Ferra & Co"(shpk) Durres.

Neni 3

Shoqeria " Ferra & Co"(shpk) Durres,ka te drejte te perdore vulen e saj ne forme rrumbullake,me madhesi te zakoneshme,me mbishktimin,shoqeria tregetare "Ferra & Co"(shpk) Durres- Albania.

Neni 4


Import eksportin e te gjitha mallrave industriale,ushqimore,blegto rale,bujqesore,materiale ndertimi,lende te para per industrine dhe sektore te tjere te ekonomise dhe tregetimin e tyre me shumice e pakice. Blerje dhe shitje pajisje elektro shtepijake te reja dhe te perdorura,si frigorifere,televizore,magnetofone,lavatriçe,etj.Blerje dhe shitje te autoveturave te reja dhe te perdorura,si dhe automjete te kapaciteteve te ndryshme.Eksportimi i lendes drusore te sharruar,etj.

Neni 5

Selia e shoqerise do te jete ne Lagjen Nr.3 rruga "Hamdi Troplini" Nr.462 Durres.

Neni 6

Kohezgjatja e veprimtarise se shoqerise "Ferra & Co"(shpk) Durres,do te jete mbi 11 vjet,duke filluar nga data e regjistrimit te saj ne Gjykatën e Rrethit Tirane dhe ne organet financiare te Tatim Taksave Durres,deri me 31.12.2050.Me pelqimin e administratorit kjo kohe mund te zgjatet.

/..


Neni 7

Shoqeria "Ferra & Co" (shpk) Durres, ka te çelur numrin e llogarise ne Degen e Bankes Kombetare Tregtare Durres, por me rritjen e kapitaleve te saj, mund te çele dhe numra llogarie ne çdo banke tjeter shqiptare, dhe ne ato private te miratuara me ligj nga shteti shqiptar.

Neni 8

Shoqeria private tregtare me emertimin "Ferra & Co" (shpk) Durres, do te vazhdoje aktivitetin e saj tregetar, pamvaresisht nga çmimet e blerjes dhe te shitjes se mallrave, duke iu neneshtuar ligjeve ekonomike te ekonomise se tregut te kerkeses dhe te ofertes.

KREU II -te

KAPITALI THEMELTAR, KONTRIBUTI I ORTAKUT

Neni 9

Fillimisht shoqeria "Ferra & Co" (shpk) Durres, do te kete nje kapital themeltar prej 100.000 (njeqind mije) leke. Kjo shume u arketua ne Degen e Bankes Kombetare Tregtare Durres. Ky kapital mund te rritet ose te zvoglohet me miratimin e ortakut te vetem administrator te shoqerise

Neni 10

Kontributi per derdhjen e kapitalit themeltar prej 100.000 lekesh eshte bere nga ortaku i vetem administrator :

1. Ramazan Isuf Ferra me shumen 100.000 leke, ose 100 per qind.

Neni 11

Kuotat e kapitalit jane lirisht te transferueshme, ne rruge trashëgimie, ne rast ndarje pasurore midis bashkeshorteve, si dhe te pasardhesve dhe te para ardhësve.

Neni 12

Shoqeria "Ferra & Co" (shpk) Durres, ka te drejten e tjetersimit te pasurise se saj. Pasuria e kesaj shoqerie mbrohet nga ligjet e shtetit shqiptar.

Neni 13

Shoqeria "Ferra & Co" (shpk) Durres, po ti krijohen mundesite, mund te investoje dhe ne shoqeri te tjera, qofshin ato me objekt te perbashket ose te perafert, por gjithenje duke respektuar ligjet e shtetit shqiptar.

KREU III -te

VITI FINANCIAR, BILANCI VJETOR, NDARJA E TE ARDHURAVE

Neni 14

Çdo vit financiar fillon me 1 janar dhe mbaron me 31 dhjetor te vitit. Por bilanci vjetor i veprimtarise financiare te shoqerise paraqitet ne organet financiare te Tatim Taksave Durres, brenda dates 31 mars te vitit pasardhes.

Neni 15

Veprimtaria e shoqerise "Ferra & Co" (shpk) Durres, mbeshtetet ne te ardhurat dhe shpenzimet e kryera dhe te evidentuara ne aktivin dhe pasi vin e bilancit periodik kontabel, dhe qe del ne perfundim te periudhes perkatese me daljen perfundimtare te bilancit periodik.

./..



Neni 16

Mbas miratimit te bilancit vjetor, dhe te evidences se fitimeve te realizuara, mbasi analizohet nga ortaku i vetem administrator i shoqerise merren prej tij te gjitha fitimet. Fitimi neto perbehet nga te ardhurat e realizuara gjate vitit financiar, pasi hiqen te gjitha shpenzimet, dhe fondi rezerve i miratuar nga ortaku i vetem administrator i shoqerise.

KREU IV -te

ORGANI DREJTUES, MARRJA E VENDIMEVE, ADMINISTRIMI DHE KONTROLLI SHOQERISE

Neni 17

Ortaku i vetem administrator i shoqerise "Ferra & Co"(shpk) Durres, merr vendimet e duhura per vazhdimesine e punes. Vendimet e marra prej tij jane te detyrueshme per zbatim nga te gjitha te punesuarit ne kete shoqeri. Ai ka te drejte te vendose per ndryshimet e dispozitave ne Kont raten e Themelimit dhe Statutin e shoqerise, per rritjen ose pakesimin e kapitalit themeltar te shoqerise, per miratimin e bilancit vjetor, per pushimin e veprimtarise se shoqerise, si dhe per ceshtje te tjera qe ai i sheh te arsyeshme.

Neni 18

Ortaku i vetem administrator ka te drejte te thirre ne mbledhje te gjitha te punesuarit sa here qe ai e sheh te arsyeshme dhe te vevojshme.

Neni 19

Ortaku i vetem administrator i shoqerise "Ferra & Co"(shpk) Durres, emeron revizorin, i cili do te kryeje revizionimin. Mbas ushtrimit te kontrollit, revizori i raporton administratorit per rezultatet .

Neni 20

Ortaku i vetem administrator, ne rrethana te veçanta, kur e gjykon te arsyeshme, ne veçanti kur ndodhet para faktit te mbylljes se aktivitetit te shoqerise, mund te organizoje mbledhjen per analizen e bilancit 6 muaj me pare.

KREU V -te

KONTABILITETI I SHOQERISE DHE KONTROLLI I TIJ

Neni 21

Kontabiliteti i shoqerise "Ferra & Co"(shpk) Durres, do te mbahet ne perputhje te plote me rregullat kontabile ne fuqi me ato te Republikes se Shqiperise.

Neni 22

Revizori i caktuar nga administratori, ka per detyre te vertetoje saktesine e bilancit. Paga e tij fiksohet nga ortaku i vetem administratori. Revizori ka te drejte te ushtroje dhe kontrolle te befasishme ne sektore te veçanta pune te shoqerise, por duhet te njoftoje 8 dite me pare administratorin.

./..



KREU VI -te

DETYRAT E ADMINISTRATORIT TE SHOQERISE

Neni 23

Shoqeria private tregetare me emertimin "Ferra & Co" (shpk) Durres, administrohet nga ortaku i vetem zoti Ramazan Ferra.

Neni 24

Administratorit, zotit Ramazan Ferra, i atribuohen fuqite me te gje-
ra per drejtimin e zakonshem dhe te jashtezakonshem te shoqerise, pa
perjashtime dhe kufizime.

Neni 25

Administratori mban pergjegjesi ligjore per mbarevajtjen e shoqe-
rise dhe per zbatimin e ligjeve te shtetit shqiptar dhe te statutit
te shoqerise.

Neni 26

Administratori i shoqerise "Ferra & Co" (shpk) Durres, ka te drejtem
e autorizimit te nje personi tjeter, brenda apo jashte shoqerise, per te
ushtruar kompetencat e tij, ne vecanti ai mund te autorizojte nje person
te besuar dhe profesionalisht te pergatitur, qe te zgjidhi drejte dhe
me kompetence problemet e tij. Por administratorin nuk mund ta zevende-
soje me shume se nje person, dhe kjo gjithenje me prokure te vertetuar
nga Dhoma e Noterise perkatese.

Neni 27

Administratorit qe nuk eshte person juridik, nuk i lejohet te kontak-
toje ne cfaredo forme qofte, te marri hua nga shoqeria, te jape pelqimin
ne emer te tij, per paredhenie, si dhe te behet dorezenes apo te jape
garanci ne emer te saj angazhimet ndaj te treteve. Ne rast te kundert
kontrata eshte e pa vlefshme.

Neni 28

Ne rast doreheqje, shkarkimi nga Gjykata per faje te renda, revokimi,
ose te pa aftesise se administratorit, cilitdo qofte shkaku, ai do te rua-
je funksionet e tij dhe tere pushtetin deri ne caktimin e nje administru-
tori tjeter.

Neni 29


Administratorit ose cilitdo person qe merr pjese ne mbledhje, jane
te detyruar te ruajne karakterin e fshehte te dokumentacionit, ne vecan-
ti te atyre te arritjeve te karakterit profesional, te arritur me vesh-
tiresi gjate aktivitetit te kesaj shoqerie, si burimet e furnizimit, etj.

KREU VII -te

PRANIMI NE PUNE DHE DETYRAT RECIPROKE NE SHOQERI

Neni 30

Per nevoja te punes e te prodhimit, shoqeria tregetare "Ferra & Co"



(shpk) Durres, ka te drejte te punesoje punonjes te kualifikuar dhe te thjeshte, duke lidhur kontrata te veçanta me sejcilin prej tyre, ose nje kontrate kolektive per te gjithë te punesuarit, duke u mbeshtetur ne ligjin "Per maredheniet e punes" dhe "Per Sindikatat", duke i noterizuar ne Dhomen e Noterise.

Neni 31,

Pagat e punes do te percaktohen nga ortaku i vetem administrator i shoqerise, ku si baze do te jete aftesia profesionale, respektimi i te gjitha kushteve te punes te vena ne kontraten e punes se lidhur me te. Pagesa do te behet duke respektuar kerkesat e te punesuarve, duke respektuar orarin e punes javore, ditet e pushimit javore, ditet e pushimit vjetor, ditet e pushimit te festave kombetare dhe ditet e festave fetare. Si dhe ti jape te gjitha te drejtat dhe lirite sindikale qe ata gezojne

Neni 32

Ne se i punesuari ben mungesa te vazhdueshme te pa paralajmeruara, te pajustificuara, qe sjellin si pasoje nderprerjen e punes ne ate sektor, punedhenesi ka te drejte ta largoje ate nga puna dhe pse nuk ka mbaruar akoma kontrata e punes se lidhur ndermjet tyre.

Neni 33

Shoqeria "Ferra & Co" (shpk) Durres, ka te drejte te kerkoje llogari te gjithë te punesuarve per respektimin me rigorozitet te gjitha kushtet e vena ne kontraten e punes se lidhur qe ne fillim. Ne se i punesuari shkakton nje dem per faj dhe pakujdesi te tij, ai eshte i detyruar ta zhdemtoje ate deri ne vleften e plote te vleftes se mallit te demtuar.

KREU VIII -te
SHKRIRJA - LIKUJDIMI

Neni 34

Shoqeria kalon ne likujdim te plote sapo ajo shkrihet, cilido qofte shkakku.

Per nevoja te likujdimit dhe deri ne mbyllje te plote te shoqerise, ajo gezon personalitet moral.

Likujdimi behet prej nje ose me shume likujdatoreve, te caktuar nga ortaku i vetem administrator, nga radhet e te punesuarve ose jashte tyre


Likujdatori gezon fuqi te plota per te realizuar aktivin dhe shlyen pasivin.

Kur shoqeria i jep fund veprimtarise se saj, pasurite qe i jane dhene me te drejte perdorimi, i kthehen pales pronare, kurse mjetet materiale dhe financiare te fituara si rezultat i veprimtarise se shoqerise, si dhe fondet e shoqerise i merr ortaku i vetem administrator i shoqerise.

KREU IX -te
DISPOZITA TE PERGJITHESHME

Neni 35

Çdo mosmarreveshje qe mund te linde ndermjet te punesuarve dhe administratorit, ndermjet shoqerise me te tretet, kur ato nuk mund te zgjidhen



me mirekuptim, atehere duhet ti drejtohen organit ligjor per zgjidhjen e tyre ne rruge ligjeshmerie. Konkretisht mund ti drejtohesh Gjykates se Rrethit Tirane, mbasi aty do ti jepet nje zgjidhje e drejte dhe e plote.

Neni 36


Ky statut merr fuqi ligjore pasi te jete neneshkruar prej administratorit dhe te jete vertetuar nga noteri i Dhomes se Noterise Durres.

Neni 37

Ky statut u pergatit ne Durres, me daten 16.10.1995, ne pese kopje ne gjuhen shqipe dhe kane te gjitha te njejten vlere ligjore.

ORTAKU I VETEM ADMINISTRATOR

RAMAZAN FERRA



REPUBLIKA E SHQIPERISE
DHOMA E NOTERISE DURRES

Nr. Rep. 3667 Nr. Kol. 2410

VERTETIM

Sot me daten 18 .10.1995, para meje Ali Turku, noter ne Dhomen e Noterise te qytetit te Durresit, u paraqit zoti Ramazan Ferra, i biri i Isufit i datelindjes 1935, me banim ne Lagjen Nr.3 rruga "Hamdi Troplini" Nr. 462 Durres, identitetin e te cilit e verifikova me ane te letres se njofimit personale. Me zotesi te plote per te vepruar, me cilesine e administratorit te shoqerise me emertimin "Ferra & Co" (shpk) Durres.

I cili pasi e lexoi statutin nen per nen dhe ne teresi dhe pasi e gjetim te rregullt e neneshkroi ate para meje me vullnetin e tij te lire

Une noteri vertetoj.....

NOTERI

Ali Turku



KONTRATE THEMELIMI
E SHOQERISE ME PERGJEGJESI TE KUFIZUAR ME EMERTIMIN "FERRA & CO" (SHPK)
DURRES

E themeloj shoqerine me pergjegjesi te kufizuar me emertimin "Ferra & Co" (shpk) Durres, une ortaku i vetem administrator:

1. Ramazan Ferra, i biri i Isufit, i datelindjes 1935, me banim ne Lagjen Nr.3 rruga "Hamdi Troplini" Nr.462 Durres.

Neni 1

Shoqeria tregtare "Ferra & Co" (shpk) Durres, do te zhvilloje aktivitetin e saj ne baze te ligjeve te shtetit shqiptar dhe te statutit te miratuar nga ortaku i vetem administrator i shoqerise "Ferra & Co" (shpk).

Neni 2

Shoqeria tregtare qe themelohet, emertohet "Ferra & Co" (shpk) Durres.

Neni 3

Objekti i shoqerise tregtare "Ferra & Co" (shpk) Durres, do te jete: Import eksporti i te gjitha mallrave industriale, ushqimore, blegtoral bujgesore, materiale ndertimi, lende te para per industrine dhe sektore te tjere te ekonomise, dhe tregtimi i tyre me shumice e pakice. Blerje dhe shitje te pajisjeve elektro shtepijake te reja dhe te perdorura, si frigorifere, televizore, magnetofone, lavatriqe, etj. Blerje dhe shitje te autoveturave dhe automjeteve te tonazheve te ndryshme, te reja dhe te perdorura. Eksportimi i lendes drusore te sharruar, etj.

Neni 4

Selia e shoqerise do te jete ne Lagjen Nr.3 rruga "Hamdi Troplini" Nr.462 Durres.

Neni 5

Kohezgjatka e shoqerise tregtare "Ferra & Co" (shpk) Durres, do te jete mbi 11 vjet, duke filluar nga data e regjistrimit te saj ne Gjykatën e Rrethit Tirane dhe ne organet e Tatim Taksave Durres, dhe mbaron me 31.12.2050.

Neni 6

Kapitalit themeltar i shoqerise "Ferra & Co" (shpk) Durres, do te jete te 100.000 leke. Per kete do te kontribuojte ortaku i vetem administrator zoti Ramazan Ferra ne masen 100 per qind te kapitalit themeltar.

Neni 7

Ortaku i vetem administrator do te perfitoje fitimin e kapitalit themeltar te depozituar ne Degen e Bankes Kombetare Tregtare Durres.

Neni 8

Shpenzimet per themelimin e shoqerise "Ferra & Co" (shpk) Durres, do te perballohen nga ortaku i vetem administrator zoti Ramazan Ferra.

Neni 9

Veprintaria e shoqerise "Ferra & Co" (shpk) Durres, mbrohet nga ligjet e shtetit shqiptar, duke i krijuar kushte pune normale.

Neni 10

Ortaku i vetem administrator eshte i detyruar te ruaje karakterin e fshahte te dokumentacionit. Neni 11

Ortaku i vetem administrator pergjigjet per veprintarine s shoqeris Po ashtu pergjigjet per demet e shkatuara nga me dashje ose pakujdesia.

Neni 12

Çdo mosmarreveshje qe mund te linde ne mes te shoqerise ne maredhe nie me te tretet, kur ato nuk mund te zgjidhen me mirekuptim, atehere

dihet ti drejtohen Gjykates se Rrethit Tirane per zgjidhje ne rruge ligjore.

Neni 13

Ne se gjate ushtrimit te aktivitetit te shoqerise "Ferra & Co"(shpk Durres,do te lindi nevoja per ndryshime ne kontraten e themelimit,ato duhen bere me te njejten menyre proceduriale,me te cilen eshte nxjerre.

Neni 14

Ortaku i vetem administrator eshte i detyruar te zbatoje kerkesat ligjore te kontabilitetit te miratuar nga shteti shqiptar.

Neni 15

Ortaku i vetem administrator eshte i detyruar te zbatoje detyrat e percaktuara ne statutin e shoqerise dhe kontratat qe do te lidhen per qdo operacion pune.

Neni 16


Kjo kontrate themelimi merr fuqi ligjore pasi te jete neneshkruar nga administratori dhe te jete vertetuar nga noteri i Dhomes Noterise.

Neni 17

Kjo kontrate themelimi u pergatit me Durres,me 16.10.1995,ne pese kopje ne gjuhen shqipe dhe kane te gjitha te njejten vlere ligjore.

ORTAKU I VETEM ADMINISTRATOR

RAMAZAN FERRA



REPUBLIKA E SHQIPERISE
DHOMA E NOTERISE DURRES

Nr.Rep. 3667 Nr.Kol. 2410

V E R T E T I M

Sot me daten 18 .10.1995,para meje Ali Turku,noter ne Dhomen e Note rise te qytetit te Durresit,u paraqit zoti Ramazan Ferra,i biri i Isu-fit i datelindjes 1935,me banim ne Lagjen Nr.3 rruga "Hamdi Troplini" Nr.462 Durres.Identitytetin e te cilit e verifikova me ane te letres se njoftimit personale.Me zotesi te plote per te vepruar,me cilesine e ortakut te vetem administrator te shoqerise "Ferra & Co"(shpk) Durres.

I cili pasi e lexoi kontraten e themelimit nen per nen dhe ne teres: e neneshkroi ate para meje me vullnetin e tije te lire.Une noteri verte toj.....

N O T E R I
Ali Turku

